



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. _____ Prot.

Kukës me, ____ . ____ .2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë ____ . ____ .2025

PËR

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 12, DATË 28.02.2025 “PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E NJË OBELISKU PËR GJEOLOGËT, MINATORËT, METALURGËT DHE ENERGJËTIKËT NË QYTETIN E KUKËSIT”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore (i ndryshuar) neni 8, pika 2, nenit 9, pika 1, 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, nenit 25, nenit 54, shkronja “m” dhe “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 , Ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në RSH, Ligj nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, , në vijim të shkreses Nr. 5117 Prot. Date 14. 11. 2024 se Shoqates Unioni Shqiptar i Inxhinierëve dhe Minierave, te:

MIRATOJË:

Pika 1 ndryshon si me poshte:

1. Miratoje dhenien e pelqimit per vendosjen e nje obelisku per gjeologet, minatorët, metalurget dhe energjitiket ne qytetin e Kukesit, ne vendin e quajtur „Sheshi perball 6-kateshit“ ne rrugen „Dituria“
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit te Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Albert HALILAJ

Konceptoi: E. Cenaj

Ligjshmeria: E. Kerxhaliu

Sekretari: E. Ramallari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 12, DATË 28.02.2025 “PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VENDOSJEN E NJË OBELISKU PËR GJEOLOGËT, MINATORËT, METALURGËT DHE ENERGJËTIKËT NË QYTETIN E KUKËSIT“

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore (i ndryshuar) nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, 1.1 shkronjat “a” dhe “b”, nenit 25, nenit 54, shkronja “m” dhe “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 , Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në RSH“, Ligjin nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” si dhe në vijim të shkresës së datës 18.04.2025 së Shoqatës Unioni Shqiptar i Inxhinierëve të Minierave, ju paraqesim për miratim Projekt/Vendimin:

“Për ndryshimin e vendimit për dhënie të pëlqimit për vendosjen e një obelisku për gjeologët, minatorët, metalurgët dhe energjetikët në qytetin e Kukësit në vendin e quajtur “Sheshi para 6 katëshit“, Rruga Dituria.

Në propozimin e parë që Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë i ka drejtuar Këshillit Bashkiak Kukës është paraqitur relacioni i plotë shoqërues i Projekt Vendimit për ***“Ndërtimin e një obelisku për gjeologët, minatorët, metalurgët dhe energjetikët në qytetin e Kukësit”*** duke shpjeguar iniciativën e ndërmarrë nga një grup specialistësh të fushës gjeologji, miniera dhe metalurgji për ndërtimin e një monumenti kushtuar kontributit që kanë dhënë ndër vite punonjësit në sektorët gjeologji-miniera dhe metalurgji, duke patur parasysh se:

- pas vitit 1961 zhvillim të vrullshëm mori prodhimi i mineralit të bakrit nga Miniera Gjegan.
- përpunimi metalurgjik daton në vitin 1965 me Uzinën Metalurgjike të Bakrit Rexhepaj.
- mbas vitit 1995 ka filluar shfrytëzimi i mineralit të Hekur- Nikelit dhe Nikel- Silikatit.

Në nderim të këtij kontributi që kanë dhënë këta punonjës, është menduar të ngrihet ky monument, i cili aq sa do të jetë vlerësim i kontributit të punonjësve, do të jetë edhe përjetësim i veprës së tyre.

Ju faleminderit !

DREJTORI

Erta CENAJ